



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 26

Datë: 08. 03. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

2. Njoftim lidhur me vendimmarrjen e PZAP-së

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore;

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në: Prishtinë dhe Istog;

4. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Valdete Daka: Fillimisht, për gratë e Kosovës, urime festa e 7 marsit. A ka dikush për rendin e ditës...?

Burmi Ahmetaj, është një pikë që do doja ta propozoja sepse, duhet vendimmarrje. Bëhet fjalë për 7 vendvotime, kështu që kjo pikë është pjesë e raportit nga QNR.

Valdete Daka, me këtë pikë të propozuar fillojmë me mbledhjen. Miratohet rendi i ditës...

2. Njoftim lidhur me vendimmarrjen e PZAP-së

Valdete Daka: Siç e dini, tashmë afati prej 72 orëve për PZAP ka përfunduar. I kemi vendimet, dhe se një numër i VV-e do të shkoj në rinumërim. E kemi një tabelë ku janë të renditura vendvotimet, dhe shpjegimet e tjera. Këto janë vendime përfundimtare. E kemi edhe vendimin që të rinumërohen votat e kandidatëve të AAK-së që kanë ardhur me postë, dhe ato me kusht.

Pra, duhet të marrim edhe ne një vendim, edhe pse vendimet e PZAP-së ne vetëm duhet t'i zbatojmë...

Sami Kurteshi: Nuk e kuptova drejt që këto vendime të PZAP-së që janë marrë, dhe a janë këtu të gjitha, apo janë edhe ato 7 kutitë...se, nuk e kuptova...!

Valdete Daka: Ne do të vendosim sipas vendimit të PZAP-së që janë vendime sipas ankesave të kandidatëve të caktuar. Vendimi për rinumërimin e votave të kandidatëve të AAK-së, po ashtu janë vendim i PZAP-së. Ne, duhet të marrim vendim njëherë për vendimet e PZAP-së...

Alim Rama: Diçka nuk po përputhet në listë si e bazuar me listën me 7 pika se, a është lista e plotë në faqen e fundit se, numri nuk po përputhet...

Burim Ahmetaj: ka të drejtë z. Rama, por për shkaqe teknike nuk i kemi përcjellë të gjitha për shkak të kohës, por vendimet duhet ti zbatojmë, ndoshta nuk kemi arritur ta rifreskojmë listën...

Valdete Daka: NE, marrim vendim për të gjitha rinumërimin e atyre që ka marrë PZAP. Sa i përketë rekomandimit lidhur me rastin, pra për 7 kutitë, kemi rekomandim nga QNR që edhe ato kuti që ku ka qenë "personi i dyshimtë" të rinumërohen...Pra, kush është për...?

Miratohet...

Burim Ahmetaj: Ju njoftoj se sot menjëherë fillon procesi i rinumërimin...

Ibrahim Selmanaj: Unë përcjellë një shqetësim tim që organet e drejtësisë dhe gjithë mekanizmat tjerë që, kushdo që ka bërë manipulim, të shihet dhe drejtësia të shkoj në vend. KQZ-së, ti vlerësohet puna, kurse ai që ka bërë manipulim le të zbulohet deri në fund...

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në: Prishtinë dhe Istog:

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar dy kërkesa për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në: Prishtinë dhe Istog, dhe ngase të dy këto kërkesa i plotësojnë kushtet ligjore ne rekomandojmë për aprovim të këtyre dy kërkesave.

Valdete Daka: E kemi kërkesën që Astrit Harizaj nga subjekti politik PDK të emërohen anëtarë i Kuvendit Komunal në Istog, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm, Blerim Hysenaj.

Po ashtu, e kemi edhe rekomandimin që Berat Lahu nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!” të emërohen anëtarë i Kuvendit Komunal në Prishtinë, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm, Adrian Berisha.

4.Të ndryshme.